



TRANSPARENCA E DIALOGUT KOSOVË-SERBI: KËNDËVËSHTRIMI I QYTETARËVE

SHTATOR 2016



HYRJE

Dialogu Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, i inicuar më 2011 si një dialog teknik dhe më pas në 2013 i vazhduar edhe si dialog politik, përveç se konsiderohet një proces i ndjeshëm, vazhdon të prodhojë kundërthënie, paqartësi dhe tensione politike.

Ky proces synon normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve, ndër të tjera shtrirjen e sovranitetit të shtetit të Kosovës në komunat veriore të vendit dhe integrimin e qytetarëve të komunitetit serb në institucionet legjitime dhe legale të shtetit. Kjo synohet të arrihet me shuarjen e strukturave paralele serbe të financuara nga shteti i Serbisë dhe kornizimi formal i marrëdhënieve të qytetarëve serb të Kosovës me shtetin e Serbisë. Element tjetër i rëndësishëm i këtij dialogu është edhe tejkalimin e pengesave të përfaqësimit, pjesëmarrjes e përfshirjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare si vend jo anëtar i OKB-së.

I gjithë ky proces ndodh me ndërmjetësimin e BE-së, e cila përdor mjetin stimulues të saj për të shtyrë palët të arrijnë dhe zbatojnë marrëveshjet - garantimit e perspektives evropiane për të dyja vendet.

Pavarësisht formulave të transparencës mbi të cilat është synuar të ndërtohet ky proces përkatësisht Rezolutave të Kuvendit të Kosovës të cilat obliguan të mandatuarin e tyre - Qeverinë për të raportuar në mënyrë të rregullt për procesin e dialogut, ato nuk arritën të prodhojnë rezultate pozitive në informimin e drejtë të qytetarëve.

Ky proces është cilësuar si një proces i mbyllur, jo transparent, të cilit i mungon gjithëpërfshirja si dhe konsensusi politik e shoqëror. Kësaj jotransparence i ka kontribuar edhe elementi 'inovativ' i negociimit - ambiguiteti konstruktiv - i cili u ka ofruar hapësirë palëve të interpretojnë marrëveshjet e arritura në verzionin e tyre. Paqartësitë vazhduan të rriten edhe më tej me interpretimet shitesë të subjekteve politike në vend për efektet që kjo mënyrë e dialogimit dhe këto marrëveshje kenë në jetën e qytetarëve si dhe në funksionimin e shtetit të Kosovës.

Por sa në të vërtetë dijnë qytetarët e Kosovës për marrëveshjet të cilat janë arritur në Bruksel? Sa janë ata të kënaqur me punën e deputetëve në mbikëqyrjen e Qeverisë për këtë proces? A janë të kënaqur me shkallën e përfshirjes së tyre në këtë proces? Nga kush presin të informohen më shumë në lidhje me procesin e dialogut? A do ishin të gatshëm që të jepnin kontributin e tyre për temat e dialogut?

Ky punim ka për qëllim të shpërfaqë përgjigjet e qytetarëve të Kosovës në këto pyetje dhe këndvështrimet e tyre për procesin e dialogut, ndërkohë që kanë kaluar 5 vite nga fillimi i këtij procesi, kur skena politike është tejet e polarizuar dhe kur është paralajmëruar një fazë e re e dialogimit Kosovë-Serbi.

Të gjeturat e këtij hulumtimi do të shërbejnë për të ndërmarrë një sërë iniciativash që kanë për qëllim të hapin diskutimin shoqëror rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi⁰⁸ dhe lidhur me efektet praktike që këto marrëveshje kanë në jetën e qytetarëve. Duke nxitur një komunikim dhe bashkëpunim midis Kuvendit, Qeverisë dhe qytetarëve, synohet të rritet transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetarëve në këtë proces.

METODOLOGJIA

Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1065 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar

sipas etniciteteve: shqiptar, serb dhe minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale). Sondazhi është realizuar në periudhën kohore 03-14 Shtator 2016. Margjina e gabimit është +-3%.

1. SA DIJNË QYTETARËT PËR MARRËVESHJET E ARRITURA GJATË PROCESIT TË DIALOGUT?


Që nga fillimi i procesit, subjektet politike opozitare kanë akuzuar qeverinë për koncesione në proces të dialogut, ndërsa Qeveria i ka portretizuar këto marrëveshje si shtrirje të sovranitetit të shtetit në tërë territorin e Kosovës. Ndërkohë që në skenën politike kanë vazhduar këto përplasje dhe akuzat sondazhi argumenton se qytetarët kanë shumë pak njohuri rreth këtyre marrëveshjeve.

Kur qytetarëve u është kërkuar të përmendin marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, 43% e tyre janë përgjigjur se nuk janë në dijeni për asnjë nga marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij procesi. Marrëveshjet të cilat qytetarët kanë arritur t'i identifikojnë në përqindje më të lartë janë: Marrëveshja për parimet themelore për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe (33% e qytetarëve), pasuar nga Marrëveshja për rivitalizimin e urës në Mitrovicë (21%) dhe Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve me 13.8%.

Ajo çfarë evidentohet është që temat të cilat kanë ngjallur debat më të madh politik e mediatic janë ato për të cilat qytetarët kanë më shumë njohuri. Ndërsa për marrëveshjet të cilat nuk kanë pasur mbulesë mediale të theksuar, qytetarët kanë më pak dijeni.

Nga analizimi i shkallës së informacionit që qytetarët kanë në bazë të përkatësisë së tyre etnike, vihet re se komuniteti serb është më i informuar rreth marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut. Marrëveshja për të cilën komuniteti serb ka më shumë dijeni është Marrëveshja e parë e parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve. E njejtja është potencuar edhe nga komunitetet tjera jo shumicë, ndërsa qytetarët e përkatësisë shqiptare kanë përmendur kryesisht Marrëveshjen për parimet themelore për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.


Gratë dalin të jenë më pak të informuara mbi marrëveshjet e arritura. Nga analizimi i njohurive rreth marrëveshjeve në aspektin gjinor, ajo çfarë vihet re është që 48% e respondentëve gra kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për asnjë nga marrëveshjet e arritura, ndërsa në të njëjtën mënyrë janë përgjigjur rreth 38% e burrave të anketuar.





	SHQIPTAR	SERB	TË TJERË
Nuk jam në dijeni për asnjë marrë	43.1%	36.0%	59.0%
Marrëveshja për urën e Mitrovicës	21.0%	30.0%	13.0%
Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve	13.1%	32.0%	18.0%
Marrëveshja për parimet themelore për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe	34.1%	10.7%	13.0%
Marrëveshja për telekomunikacion (kodi telefonik)	9.1%	18.7%	0.0%
Marrëveshja për drejtësi	6.1%	15.3%	1.0%
Marrëveshja për lëvizjen e lirë	11.3%	0.0%	7.0%
Marrëveshja për shpërbërjen e të ashtuquajturës 'mbrojtja civile'	2.2%	14.0%	2.0%
Menaxhimi i integruar i kufirit (IBM)	6.9%	3.3%	3.0%
Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave profesionale dhe akademike	4.5%	7.3%	1.0%
Marrëveshja për sigurimin e automjeteve	3.4%	3.3%	4.0%
Marrëveshja për energji	3.8%	4.7%	0.0%
Marrëveshja për vizitat zyrtare	3.3%	2.7%	2.0%
Vulat doganore	4.5%	1.3%	2.0%
Marrëveshja për zyrtarët ndërlidhës	2.3%	1.3%	3.0%
Regjistrat civil (librat amzë)	3.8%	0.0%	1.0%
Marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore	2.6%	1.3%	0.0%
Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal (fusnota)	2.0%	0.7%	1.0%
Marrëveshja për njohjen reciproke të Certifikatave ADR (liria e lëvizjes së mallrave të rrezikshme sipas konventës ADR)	2.8%	0.7%	0.0%
Regjistrat kadastral	3.3%	0.0%	0.0%
Tjetër, specifiko:	0.1%	0.0%	0.0%





2. NGA KUSH PRESIN QYTETARËT E KOSOVËS TË INFORMOHEN PËR PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI?

Mungesa e transparencës dhe informimit të qytetarëve rreth marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi konsiderohet si një ndër temat më kontestuese të këtij procesi.


Kur qytetarëve u është kërkuar të rradhisin akterët të cilët ata mendojnë se duhet t'i informojnë më shumë rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi, ajo çfarë është evidentuar është që të anketuarit kanë rradhitur Qeverinë si institucionin kryesor nga i cili presin të marrin informacione, duke rradhitur Kuvendin si institucionin e dytë përgjegjës për dhënien e informacionit, dhe duke vazhduar më pas me mediat, kryetarët e komunave dhe shoqërinë civile.


Nga analizimi i qëndrimit të qytetarëve të kategorizuara sipas përkatësisë etnike vihet re një ndryshim në rankimin e akterëve përgjegjës për dhënien e informacionit.

Përderisa respondentët shqiptar dhe komunitetet tjera joshumicë e konsiderojnë Qeverinë si përgjegjësen kryesore për informim rreth procesit të dialogut, respondentët nga etniciteti serb në fakt e listojnë Qeverinë si të fundit nga akterët që presin të marrin informacione për procesin e dialogut. Sipas të anketuarëve të komunitetit serb, janë kryetarët e komunave të cilët duhet të bartin barrën kryesore rreth informimit të qytetarëve për dialogun, pasuar nga mediat, Kuvendi, shoqëria civile dhe fare në fund Qeveria.

Ndërsa sa i përket të anketuarve të përkatësisë shqiptare, pas Qeverisë, përgjegjësinë për informim rreth dialogut duhet ta mbajë Kuvendi, mediat, Kryetarët e Komunave dhe shoqëria civile. Renditje të përafërt të akterëve kryesor rreth informimit për procesin e dialogut kanë dhënë edhe të anketuarit e komuniteteve tjera joshumicë që jetojnë në Kosovë. Ata e konsiderojnë Qeverinë e Kosovës si përgjegjësen kryesore për informim, të ndjekur nga mediat, Kuvendi, shoqëria civile dhe kryetarët e komunave.

Ndërsa nga aspektin gjinor në kërkesën për llogaridhënie dhe informacion, i vetmi ndryshim është që burrat rradhisin shoqërinë civile dhe më pas kryetarët e komunave. Ndërsa nga aspekti i grup moshave, nuk vihet re ndryshim në rankimin e përgjegjësve kryesor për shtimin e dhënies së informacionit nga të gjeturat e përgjithshme.





3. SI E VLERSËSOJNË QYTETARËT MBIKËQYRJEN E KUVENDIT KARSHI QEVERISË PËR PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI?


KDI në këtë sondazh i ka dhënë hapësirë të rëndësishme mbikëqyrjes parlamentare si një nga detyrat bazë që Kuvendi duhet të ushtrojë me qëllim që të sigurohet që Qeveria përmbush interesat e qytetarëve të saj dhe punon për një kualitet më të mirë të jetës së tyre. Për më tepër, rezolutat e miratuara nga Kuvendi në raport me procesin e dialogut, e obligojnë Qeverinë dhe të mandatuarin e saj për të raportuar në mënyrë të rregullt mbi procesin e dialogut.


Të dhënat e sondazhit tregojnë që 76% e qytetarëve janë përgjithësisht të pakënaqur me mbikëqyrjen e Kuvendit ndaj Qeverisë për procesin e dialogut. Specifikisht, 44% e të anketuarve janë shprehur të pakënaqur kurse 32% shumë të pakënaqur me

mbikëqyrjen që Kuvendi ia bën Qeverisë për procesin e dialogut Kosovë – Serbi. Nga numri i përgjithdhëm i të anketuarve, 10% kanë deklaruar se nuk dinë se si ta vlerësojnë rolin mbikëqyrës të Kuvendit mbi Qeverinë rreth procesit të dialogut, kurse niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e Kuvendit sa i përket mbikëqyrjes së Qeverisë në këtë drejtim është vetëm 14%.

Ndërsa nga vlerësimi i shkallës së pakënaqësisë së qytetarëve në bazë të përkatësisë së tyre etnike, vihet re që 85% e të anketuarëve që u përkasin komunitetit serb janë të pakënaqur me punën e Kuvendit në mbikëqyrjen e Qeverisë rreth procesit të dialogut, krahasuar me 77% të komunitetit shqiptar dhe 51% të komuniteteve të tjera joshumicë.

Fakt interesant paraqesin shifrat e të anketuarve nga komunitetet tjera joshumicë, ku 21% deklarohen se janë të kënaqur me nivelin e mbikëqyrjes së Qeverisë nga ana e Kuvendit rreth dialogut Kosovë-Serbi, shifër kjo më e lartë në krahasim me kategoritë tjera ku rreth 11% e komunitetit serb janë të kënaqur me punën që Kuvendi e bën në këtë drejtim, ndërsa rreth 14% e komunitetit shqiptar.





4. SI E VLERËSOJNË QYTETARËT PËRFSHIRJEN E TYRE E (PËRMES KONSULTIMEVE PUBLIKE, DEBATEVE) NË PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI?


Që demokracia të funksionojë nevojitet angazhim dhe përfshirje e drejtpërdrejtë e qytetarëve dhe shoqërisë civile. Përfshirja i ndihmon qytetarët të mësojnë dhe të japin zgjidhje për çështjet në interes të tyre. Përfshirja e qytetarëve në procesin e dialogut Kosovë-Serbi është vlerësuar si domosdoshmërinë krijim e konsensusit shoqëror rreth çështjeve të cilat diskutohen dhe sigurimit të një procesi më gjithpërfshirës dhe më transparent.

Lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, rreth 75% e tyre janë shprehur të pakënaqur me përfshirjen e tyre në dialog përmes mekanizmave praktik si

debatet apo konsultimet publike. Vetëm 13% të të anketuarëve kanë deklaruar se janë të kënaqur me përfshirjen e tyre në këtë process, ndërsa 12% e të tyre kanë deklaruar se nuk e dijnë ose nuk kanë përgjigje në këtë pyetje.

Nga vlerësimi i njëjtë në bazë të përkatësisë etnike të të anketuarëve, ajo që vihet re është se rreth 84% e të anketuarëve nga komuniteti serb kanë deklaruar se nuk janë të pakënaqur me përfshirjen e tyre në procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar rreth 75% e tyre kanë shprehur pakënaqësi rreth përfshirjes së tyre në procesin e dialogut. Për sa i përket komuniteteve të tjera jo shumicë rreth 55% e të anketuarëve janë shprehur të pakënaqur me mundësinë e pjesëmarrjes në diskutime publike rreth çështjeve të lidhura me dialogun.




5. SA DO TË ISHIN TË GATSHËM QYTETARËT TË PËRFSHIHEN NË DISKUTIMËT PËR TEMAT E DIALOGUT KOSOVË-SERBI (PËRMES KONSULTIMEVE PUBLIKE, DEBATEVE APO FORMAVE TJERA)?

Çmontimi i procesit të dialogut në implikime praktike që marrëveshjet sjellin në jetën e përditshme të qytetarëve do të hapte rrugë dhe interesim për qytetarët të përfshihen në dialog përmes të zgjedhurve të tyre. Në pyetjen e fundit se a do të ishin të gatshëm të përfshiheshin në diskutimet për temat e dialogut Kosovë-Serbi, përkundër shprehjes së hapur së pakënaqësisë me përfshirjen e tyre në këtë proces deri në këtë fazë, 57% e anketuarëve janë deklaruar se nuk do të ishin të gatshëm të përfshiheshin në diskutime rreth dialogut. Në anën tjetër, 26% e të anketuarve kanë shprehur gatishmëri për t'u përfshirë në diskutime publike apo forma të tjera diskutimi rreth temave të dialogut, kurse 17% e respondentëve kanë shprehur hezitim nëse do të përfshiheshin në këtë proces ose jo. Këto rezultate patjetër se vijnë nga mungesa e transparencës së procesit të dialogut dhe konfuzionit që ai ka krijuar te qytetarët.

Nga analizimi i gatishmërisë së qytetarëve për tu përfshirë në procesin e dialogut Kosovë-Serbi në bazë të përkatësisë së tyre etnike, rreth 27% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar janë më të interesuarit të marrin pjesë në diskutimet publike, ndërsa rreth 56% e tyre janë të paaftësuar të përfshihen në këtë proces. Rreth 16% kanë deklaruar se nuk e janë të sigurtë nëse do të dëshironin të përfshiheshin ose jo në procesin e dialogut Kosovë – Serbi.

Sa i përket të anketuarve nga komuniteti serb, vetëm 12% të respondentëve janë shprehur të gatshëm për t'u përfshirë në procesin e dialogut, përkundër 49% të tyre që nuk duan të përfshihen fare dhe 39% të tjerë ende nuk e dinë nëse duan të jenë pjesë e diskutimeve publike rreth dialogut apo jo.



Ndërsa, 13% e të anketuarve nga komunitetet tjera joshumicë do të donin të përfshiheshin në aktivitete rreth temave të dialogut, përkundër 66% të tyre që nuk kanë shfaqur interesim për një gjë të tillë dhe 21% që ende nuk e dinë nëse duan të marrin pjesë në diskutimet publike për dialog apo jo.

Sa i përket ndarjes sipas gjinisë, respondentët burra janë shprehur shumë më të gatshëm se gratë të përfshiheshin në diskutime publike rreth temave të dialogut. 34% e burrave kanë deklaruar se do të merrnin pjesë në diskutimet e organizuara për dialogun, kurse vetëm 19% të grave kanë shprehur vullnetin e njëjtë. Megjithatë, në përgjithësi dominon mungesa e vullnetit për përfshirje në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, ku 51% e burrave dhe 62% e grave të anketuara kanë deklaruar se ata/ato personalisht nuk do të dëshironin të përfshiheshin në çështjet që kanë të bëjnë me dialogun.

Në kategorizimin sipas moshës, të anketuarit e moshës 24-35 vjeç (30%) dhe ata mbi 65 vjeç (36%) janë shprehur më të gatshëm për të qenë pjesë e diskutimeve publike dhe konsultimeve rreth temave të dialogut. Në anën tjetër, refuzuesit më të mëdhenj për përfshirje në këtë proces i takojnë grupmoshës 45-54 vjeç me 63% të respondentëve, ndonëse edhe të anketuarit e grupmoshave tjera qëndrojnë përafërsisht njëjtë me qëndrime, të gjithë me mbi 50% të shkallës së refuzimit të pjesëmarrjes në debate për dialog Kosovë- Serbi.

	PO	JO	Nuk e di
SHQIPTAR >	27.2%	56.7%	16.1%
SERB >	12.0%	48.7%	39.3%
TË TJERË >	13.0%	66.0%	21.0%

KONKLUZAT DHE REKOMANDIMET

Të gjeturat e këtij hulumtimi të opinionit vërtetojnë që qytetarët e Kosovës në shkallë të lartë janë të painformuar rreth marrëveshjeve të cilat janë arritur në kuadër të procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Ata kanë një nivel të lartë të pakënaqësisë rreth mbikëqyrjes që Kuvendi përgjithësisht ushtron ndaj Qeverisë në këtë proces. Për më tepër ata janë të pakënaqur me nivelin e përfshirjes së tyre ndërsa shprehin hezitim për t'u përfshirë në të ardhmen në këtë proces. Në bazë të këtij sondazhi, në përgjithësi qytetarët presin të informohen më shumë në rradhë të parë nga Qeveria dhe më pas nga Kuvendi i Kosovës.

Bashkimi Evropian si dhe komuniteti ndërkombëtar ka shprehur mbështetjen më të lartë për këtë proces duke e cilësuar si kyç për garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, si dhe për rrugëtimin drejtë së ardhmes evropiane të të dyja vendeve.

Duke konsideruar që procesi i dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë pritet të hyjë në një fazë të re të diskutimit, duke konsideruar që të arriturat nga ky dialog do të ndikojnë drejtëpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe funksionimin e shtetit të Kosovës, duke konsideruar rëndësinë e ndërtimit të konsensusit shoqëror dhe politik në avansimin e mëtejme të këtij procesi, KDI rekomandon të ndërmerren hapat e mëposhtme:

1. Qeveria duhet të rris transparencën rreth marrëveshjeve të arritura, të artikulojë qartë se si këto marrëveshjet prekin jetën e qytetarëve, të mbaj të informuar në mënyrë konstante dhe të rregullt Kuvendin dhe qytetarët për progresin e përgjithshëm ose sfidat në implementim të marrëveshjeve të arritura.

2. Qeveria duhet të ndërmarr masa për të krijuar një consensus më të gjerë politik dhe shoqëror duke rritur përfshirjen e qytetarëve dhe të gjithë aktorëve në artikullimin e çështjeve të cilat do të diskutohen në kuadër të dialogut, të artikulojë qartë të ardhmen e dialogut dhe qëllimin përfundimtar të tij.

3. Deputetët e Kosovës duhet të luajnë një rol të shtuar në mbikëqyrjen e Qeverisë duke kërkuar llogaridhënie në kuadër të procesit të dialogut, përkatësisht dikastere të cilat janë bartëse në zbatimin e marrëveshjeve, duke përdor mjetet parlamentare që kanë në dispozicion si interpelanca, pyetjet parlamentare, raportimet me synimin për të ndërtuar demokraci më të përgjegjshme.

4. Komunikimi me qytetarët duhet të kthehen në synim si për Qeverinë ashtu edhe për Kuvendin për të evituar konfuzionin e krijuar, për të ulur pakënaqësinë e lartë që ata kanë si dhe për të ndërtuar mbi përgjegjshmërinë.

5. Kuvendi dhe Qeveria duhet të shtojnë komunikimin e ndërsjellë, të monitorojnë nga afër zbatimin e marrëveshjeve, komunitetet duhet të përfshihen më shumë në këtë bashkëbisedim.

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA